VENDIM
Nr.420, datë 27.2.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVIZIONIN KABLLOR PRIVAT "K.A.M"

PERSONIT FIZIK: Z.BESNIK DELIU

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.375, datë 30.11.2005, rregullores "Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll", të miratuar me vendimin e KKRT-së nr. 221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit, z. Besnik Deliu, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetin e Peqinit.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj